

IZER MAKSUTI

RRETH KONTRIBUTIT ALBANOLOGJIK TË ARMIN HETZER

811.18'374=112.2

Abstrakt: Është i njohur kontributi i studiuesve të huaj, sidomos i atyre gjermanë dhe austriakë në fushë të albanologjisë.

Një ndër përfaqësuesit më të njohur të pjesës së dytë të shek. XX është edhe albanologu gjerman Armin Hetzer.

Në këtë kumtesë kemi për qëllim të japim një pasqyrë përmbledhëse rreth kontributit të tij albanologjik. Duke nisur me studimet e shumta për gjuhën shqipe, do të ndalemi sidomos te 3 kryeveprat e tij: fjalori “Shqip-gjermanisht / gjermanisht – shqip”, libri (së bashku me Zuzana Finger) për mësimin e gjuhës së njësuar letrare shqipe dhe vepra e tij kryesore, punimi i habilitimit: “Nominalisierung und verbale Einbettung in Varietäten des Albanischen“ (Substantivimi dhe ndërkallja verbale në gjuhën e shkruar të sotme shqipe).

Në fund jemi munduar të përmbledhim në një bibliografi sa më të plotë të gjithë kontributin e tij albanologjik.

Fjalë kyçe: *Albanologji, albanolog gjerman, gjuha shqipe, leksikografi, bibliografi*

Na gëzon fakti që kohëve të fundit gjithë e më shumë po debatohet e botohet për kontributin e albanologëve të huaj, sidomos për traditën e madhe të albanologjisë austro-gjermane dhe kontributin themeltar të përfaqësuesëve të saj për studimin e historisë, kulturës, gjuhës dhe letërsisë shqipe.¹ Në këtë frymë, në kuadër të Seminarit të vitit të kaluar (2017), në sesionin e gjuhësisë kemi temën: “*Kontributi i albanologëve të huaj për gjuhën shqipe*”.

Si gati shumica e asaj plejade të albanologëve të huaj fillimisht kishin studiuar, indogjermanistikë, filologji klasike, sllavistikë, romanistikë, ballkanologji e drejtime të tjera dhe më vonë i futeshin studimit të shqipes.

Si pjesë e kësaj tradite është edhe Armin **Hetzer** (27.12.1941, (Bonn-)Bad Godesberg), i cili studioi sllavistikë, sinologji dhe filozofi në Bonn, Köln dhe Göttingen. Hetzer vetë preferon të thotë se është ballkanolog, e jo albanolog, por ai mbetet një ndër albanologët më të dalluar nga Gjermania Perëndimore, në pjesën e dytë të shekullit XX. Hetzer u specializua për gjuhët e Evropës Juglindore, por nga viti 1975 merrej kryesisht me gjuhën dhe letërsinë shqipe, duke qenë i punësuar në Bibliotekën Shtetërore dhe në Bibliotekën e Universitetit të Bremen-it.²

¹ Shih më shumë për këtë: Izer Maksuti: Rreth studimeve albanistike në hapësirën gjermanishtfolëse – një vështrim i përgjithshëm. Në: ALBANOLOGJIA, International Journal of Albanology, Tetova, Vol. 4, No. 7, 2017, fq. 57-72. (shih edhe online në: <https://univie.academia.edu/IzerMaksuti>) – Kumtesë e mbajtur në Seminarin Albanologjik në shtator 2016, Tetovë.

² https://de.wikipedia.org/wiki/Armin_Hetzer (19.09.2017)

Habilitoi në vitin 1994 me temën: *Nominalisierung und verbale Einbettung in der modernen albanischen Schriftsprache* (Substantivimi dhe ndërkallja verbale në gjuhën e shkruar të sotme shqipe)¹

Pas vitit 1994 si profesor inordinar në Universitetin e Bremen-it mbajti leksione kryesisht mbi tema të gjuhësisë së përgjithshme. Pati përpjekje që të trashëgoj Martin Camajn në Munih, para ardhjes së Bardhyl Demirajt aty.

Në kuadër të programit të Fondacionit Johann Gottfried Herder² ka qenë profesor i ftuar edhe në disa vende të Evropës Lindore, ndërsa në semestrin veror 2006, qendroi në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë. Me profesor Hetzer atëherë zhvilluam një intervistë që u botua në revistën UNIVRSITAS.³

Do të ndalemi që në fillim te kjo intervistë, pasi aty edhe sot gjejmë të dhëna tepër të dobishme, jo vetëm mbi jetën, por mbi të gjitha mbi kontributin e tij albanologjik. Në atë intervistë ndër të tjera na flet edhe për pjesëmarrjen në vitet 70-të të shekullit të kaluar, në një seminar veror të sllavistëve në Maqedoni dhe tregon për shqiptarin e parë që ka takuar:

“Më në fund takova një filan Berisha nga Prizreni që shiste qylafë të bardha dhe përparëse femrash si dhe sende të tjera në tregun e Ohrit. Ai ishte i pari shqiptar, me të cilin kam biseduar; ai më ftoi në kafene për të bërë muhabet. E takova përsëri dy vjet më pas në Ulqin ku shiste qilima. Atëherë (1976) flisja tanimë lirisht shqip, sepse me gruan kisha një dhomë te një familje shqiptare”.⁴

Po këtu profesor Hetzer në pyetjen e bërë: “*Ju jeni ndër albanologët e paktë që ka Gjermania dhe bota gjermanishtfolëse sot. A mund të na thoni diç më shumë për albanologët gjermanë⁵ dhe vatrat albanologjisë në Gjermani?*”, e përshkruan shumë qartë interesin e paktë për shqipen dhe gjendjen e studimeve albanologjike në hapësirën gjermanishtfolëse sot:

“Më vjen keq, mendoj se jam albanologu i fundit në Gjermani. Është punë e njohur se për shkaqe të financimit në të gjitha universitetet që nga Berlin deri në Mynih katedrat e gjuhëve sllave, të ballkanologjisë etj. janë duke u likuiduar. Kur profesorët shkojnë në pension, katedrat përkatëse mbyllen. E para që katedra e prof. Reiter-it në Berlinin Perëndimor. Katedra e shqipes në Mynih është një përjashtim, por Bardhyl Demiraj, i cili e mban këtë katedër, merret vetëm me çështje të etimologjisë dhe të shkrimeve të vjetra shqipe (Buzuku etj.). Sa për albanologë gjermanë të rinj s'mund të them asgjë; ata me nam janë në moshë si unë, dhe s'ka perspektivë që situata të ndërrojë në afat të shkurtër. Ndoshta mbin një diletant si unë që entuziazmohet për gjuhën dhe kulturën shqiptare larg nga fakultetet përkatëse. Duhet thënë këtu se as Robert Elsie, kanadez që jeton në Gjermani, nuk ka pasur sukses të sistematizojë në ndonjë institut; ai është shkrimtar i lirë (freelance writer) dhe boton vazhdimisht punime shumë të vlefshme, si në gjermanisht, ashtu edhe në anglisht. Historia e letërsisë shqipe, botuar anglisht disa vjet më parë në SHBA, është fryt i veprimtarisë së Elsie-s në Gjermani.”⁶

¹ Hetzer, Armin: *Nominalisierung und verbale Einbettung in Varietäten des Albanischen: eine Untersuchung zur Geschichte der albanischen Schriftsprache am Beispiel erweiterter Verbalprädikate auf areallinguistischem Hintergrund*. Wiesbaden: Harrassowitz 1995. XI, 297 S. (= Balkanologische Veröffentlichungen 28).

² <https://www.daad.de/ausland/lehren/dozenten/de/4401-johann-gottfried-herder-programm-fuer-hochschullehrer-im-ruhestand/> (21.06.2017).

³ Shih: Intervista: *Armin Hetzer – Ballkanolog, albanolog*. Në: UNIVERSITAS – Revistë për Shoqëri, Shkencë dhe Kulturë. Tetovë 2006, Viti V, Nr. 8, fq. 233 – 242.

⁴ Po aty, fq. 234.

⁵ Për më tepër shih punimin e tij: „Zur Geschichte der deutschsprachigen Albanologie: 150 Jahre seit Erscheinen von Josef Ritter von Xylanders Handbuch des Albanischen (1835)“. – *Balkan-Archiv*. Neue Folge, 10 (1985), f. 179-217.

⁶ Intervista me A. Hetzer (2006), fq. 234-235.

Do të përmendim këtu në mënyrë kronologjike dhe me veçim tematik studimet e tija të shumta, botuar kryesisht në 3-4 revistat më me nam në fushë të ballkanologjisë, në botën gjermane, por jo vetëm, si: *Balkan-Archiv. Neue Folge* (Wissenschaftlicher Verlag A. Lehmann), *Südost-Forschungen*,¹ *Südosteuropa-Mitteilungen*² dhe *Zeitschrift für Balkanologie*³.

Po dallojmë disa prej tyre: “Ortografi e ortoepi. Mbi gjendjen e gjuhës së shkruar shqipe pas Kongresit të Drejtshkrimit më 25.11.1972 në Tiranë”,⁴ “Si mund të lexohet Fjalorthi i Arnold von Harffit”,⁵ tre artikuj mbi “Të ashtuquajturin Kodeks të Beratit”,⁶ një studim mbi “Fjalorin tre gjuhësh të Teodor Kavalliotit”, si dhe botimin e përpunuar edhe në gjermanisht të këtij fjalori (shqip, gjermanisht, greqisht, arumunisht).⁷

Po në këtë periudhë, në fillim të viteve 80-të të shek. XX, Hetzer është po ashtu bashkautor i një bibliografie me shumë vlerë mbi Shqipërinë, ndër të vetmet botuar jashtë.⁸

Armin Hetzer ka veçmas kontribut për studimin nga një këndvështrim tjetër të një periudhe të letërsisë shqipe, Letërsinë e bejtexhinjve”, e ashtuquajtura “Letërsia alhamiada” me shkronja arabe. Janë hulumtimë mbi letërsinë shqipe me shkrim arab dhe rëndësinë e saj në kuadër të lëvizjes kombëtare të shekullit XIX. Aty flet për rolin e saj në historinë e kulturën shqiptare të pa studiuar ende si duhet. Ai ka përpunuar “Ervehenë” nga origjinali, që ndryshon nga botimi i mëvonshëm në alfabetin e Stambollit dhe ribotimet me alfabetin e sotëm shqip.⁹

Rolin themeltar të kësaj letërsie për shqiptarët në atë kohë ai e përshkruan kështu:

“Meqenëse shumica e shqiptarëve që nga fillimi i shek. XVIII kishin pranuar islamin, veprat fetare të klerikëve katolikë (sidomos Bogdani) ose ortodoksë s'mund të ndikonin në jetën kulturore të shumicës së popullatës. Por veprat orientale (mevlud, epopetë e Nezimit, mbledhje novelash) në përkthim apo në ndonjë formë të adaptimit (Nachdichtung) mund të arrinin edhe në jetën e shqiptarëve analfabetë.”¹⁰

Pasojnë studimi dhe botimi monografik mbi “Historinë e tregtisë së librit në Shqipëri deri më 1912”.¹¹

Hetzer merret edhe me tema tjera të zhvillimeve të brendshme politike në Shqipëri, shkruan për aspektet e subjektivitetit dhe zhvillimet kulturo-politike nga 1945 në Shqipëri etj.¹

¹ <https://www.ios-regensburg.de/ios-publikationen/zeitschriften/suedost-forschungen.html>

² <https://www.sogde.org/publikationen/suedosteuropa-mitteilungen/>

³ <http://www.zeitschrift-fuer-balkanologie.de/index.php/zfb>

⁴ A. Hetzer: *Orthographie versus Orthoepie. Zur Situation der albanischen Schriftsprache nach dem Rechtschreibungskongress vom 25.11.1972 in Tirana*. In: ZfB 14 (1978), fq. 42-49.

⁵ Armin Hetzer: „Wie ist Arnold von Harffs Wörterverzeichnis (1496) zu lesen? Ein Beispiel für das Ineinandergreifen von albanischer und deutscher Sprachgeschichtsforschung“. - *Balkan-Archiv. Neue Folge*, 6 (1981), fq. 229-262.

⁶ A. Hetzer: *Der sogenannte Kodex von Berat*. I. Në: BA. NF, 6 (1981), fq. 123-198; I njëjti: *Der sogenannte Kodex von Berat. II. Untersuchungen zu einer anonymen griechisch-albanischen Handschrift vom Ende des 18. Jahrhunderts*. Në: SOF, 41 (1982), fq. 131-179; I njëjti: *Der sogenannte Kodex von Berat III*. In: BA. NF, 9 (1984), fq. 153-178;

⁷ A. Hetzer (Bearb./përpunim): *Das dreisprachige Wörterverzeichnis von Theodoros Anastasiu Kavalliotis aus Moschopolis, gedruckt in Venedig*. Hamburg: Buske 1981. 278 S. (BA. NF, Beiheft 1); I njëjti: *Neues zu Kavalliotis „Protopeiria“ (1770). Beobachtungen am Bukarester Original und einigen Nachdrucken des dreisprachigen Wörterverzeichnisses aus Moschopolis*. Në: BA. NF, 8 (1983), fq. 95-158.

⁸ I njëjti: VIOREL, S. Roman: *Albanien. Ein bibliographischer Forschungsbericht*. München, New York u.a.: Saur 1983. 653 S.

⁹ A. Hetzer: *Der Wortschatz und die Orthographie der „Erveheja“ von Muhamet Kycyku-Çami*. Në: BA. NF, 8 (1983), fq. 197-290; I njëjti: *Die „Erveheja“ von Muhamet Kycyku-Çami. Eine Untersuchung zur albanischen Literatur in arabischer Schrift und deren Bedeutung im Rahmen der Nationalbewegung des 19. Jahrhunderts*. - *Südost-Forschungen* (München), 43 (1984), fq. 181-239; i njëjti: *Untersuchungen zur albanischen Aljamiado-Literatur am Beispiel einer Handschrift von Muhamet Kycyku-Çami's „Erveheja“*. - *Zeitschrift für Balkanologie*, 21 (1985), fq. 12-40; Shih po ashtu studimin e albanologut Robert Elsie mbi “Historinë e letërsisë shqiptare”, kapitulli V.: <http://www.elsie.de/pdf/B1997HistLetShqip.pdf>

¹⁰ Intervista me A. Hetzer (2006), fq. 236-237.

¹¹ A. Hetzer: *Problemtopik zu einer Geschichte des Buchhandels in Albanien bis 1912*. Në: BA. NF, 8 (1983), fq. 159-186; I njëjti: *Geschichte des Buchhandels in Albanien. Prolegomena zu einer Literatursoziologie*. Berlin: Osteuropa-Institut an der FU Berlin. In Kommission bei Otto Harrassowitz, Wiesbaden 1984. 212 S. (= *Balkanologische Untersuchungen* 10).

Vlen të përmenden edhe artikujt për gjuhën e njësuar letrare shqipe dhe mbi problematikën e standardizimit të saj, si dhe debatin pas viteve 90-të mbi standardin.²

Po shkëpusim këtu pjesë nga intervista e lartpërmendur, përgjigjen e tij për njësimin dhe se a është i kthyesëm procesi i standardizimit të shqipes:

“Po, është i kthyesëm, në qoftë se budallenj pa ndërgjegje ose fanatikë si Arshi Pipa kanë fuqinë përkatëse. Në themel, pyetja është: deri në çfarë shkalle gegërishtja veriore mund të shfrytëzohet në letërsi, në shtyp, madje në shkollë etj. Ju them troç se unë blej çdo libër (ribotim ose botim origjinal) në gjuhën e paraluftës; tash gjenden në raft pranë meje Kujtimet e Ndoc Nikajt, poezitë e Vinçenc Prenushit dhe tregimet e Ernest Koliqit - si dhe botimi i katërt i *Lahutës së Malsisë*. Me fjalë të tjera, unë, ndoshta, jam njohësi më i mirë i letërsisë shkodrane në Gjermani. Mirëpo, unë jam kundërshtar i flaktë i revizionizmit gjuhësor.

Në situatën e sotme ka prioritete të tjera në Shqipëri, s'duhet humbur mjete, forca dhe talente për një punë të dështuar. Niveli i shkollimit në Shqipëri ka rënë dramatikisht, dhe në republikat ose krahinat e ish-Jugosllavisë niveli s'ishte i mjaftueshëm kurrë (kam ndërmend gratë dhe punëtorë të thjeshtë). Prandaj them: mos prekni standardin e gjuhës letrare, sepse as vende më të pasura nuk kanë dy variante të gjuhës së shkruar. Shikoni, anglishtja është - *more or less* - e njëjta në Angli, në SHBA, në Australi dhe në vende të tjera, megjithëqë gjuha e folur ndryshon krejt. Me fjalë të tjera, duhet dalluar për çfarë standardi është fjala (drejtshqiptim, gramatikë etj).

Natyrisht, kritika është e mundshme. P. sh. shkrimi i emrave të përveçëm të huaj në gjuhën shqipe nuk i përgjigjet më kushteve të ndërruara. Në 1974 Shqipëria s'kishte lidhje të drejtpërdrejt me botën e jashtme, dhe shqiptarët e ish-Jugosllavisë jetonin në kontakt me alfabetin sllav, në të cilin emrat e përveçëm shkruhen sipas shqiptimit. Tani është ndryshe, dhe mendoj se është koha që gjuha shqipe si gjuha e fundit e Evropës të pranojë rregullimin e OKB-së, sipas të cilit në vende me alfabet latin të gjithë emrat shkruhen si në origjinal latin. Pra duhet *Shakespeare*, jo Shekspiri, *Voltaire*, jo Volteri etj.”³

Po përmendim edhe këto dy tema mbi veçoritë e terminologjisë juridike dhe religjioze në shqipen e sotme,⁴ kontributin “Mbi historinë e albanologjisë gjermanofone”,⁵ si dhe disa studime mbi kontaktin gjuhësor të shqipes me gjuhë tjera.⁶

Hetzer po ashtu ka një punim “Mbi letërsinë shqipe në epokën e socializmit”⁷ dhe një studim tjetër mbi letërsinë shqipe si “*Shqipnia dhe Shqenia* në Lahutën e Malësisë të Fishtës”.⁸

¹ A. Hetzer: *Aspekte der Subjektivität in der albanischen Kulturpolitik (1965-1975)*. Bremen: Übersee-Museum, 1979. 163 S. (Veröffentlichungen aus dem Übersee-Museum, Reihe D, Bd. 5); I njëjti: *Albaniens kulturpolitische Entwicklung seit 1945*. Në: BA. NF, 7 (1982), fq. 79-94; I njëjti: *Albaniens innere Entwicklung seit 1945*. Në: Südosteuropa-Mitteilungen (München) 23 (1983) 1, fq. 39-49; I njëjti: *Die innenpolitische Entwicklung Albaniens seit dem Zweiten Weltkrieg*. Në: BA. NF, 9 (1984), fq. 49-72.

² A. Hetzer: *Ist der Prozeß der Sprachnormierung in Albanien reversibel?* Në: Hinrichs, Uwe [Hrsg.]: *Sprache in der Slavia und auf dem Balkan: slavistische und balkanologische Aufsätze; Norbert Reiter zum 65. Geburtstag*. Wiesbaden: Harrassowitz 1993, fq. 91-100. (Opera Slavica; N.F., 25); I njëjti: *Die vereinheitlichte albanische Sprache nach der politischen Wende*. Në: Schaller, Helmut [Hrsg.]: *Sprache und Politik: die Balkansprachen in Vergangenheit und Gegenwart*. München: Südosteuropa-Gesellschaft 1996, fq. 323-345.

³ Intervista me A. Hetzer (2006), fq. 237-238.

⁴ A. Hetzer: *Die strafrechtliche Terminologie in der albanischen Sprache. Eine philologische Wortschatzuntersuchung [...]*. Në: ZfB, 16 (1980), fq. 25-60; I njëjti: *Das lexikalisch-phrasologische Subsystem der religiösen Terminologie im heutigen Albanisch nach den politischen Veränderungen*. Në: ZfB, 32 (1996) 2, fq. 157-166.

⁵ A. Hetzer: *Zur Geschichte der deutschsprachigen Albanologie: 150 Jahre seit Erscheinen von Josef Ritter von Xylanders Handbuch des Albanischen (1835)*. BA. NF, 10 (1985), fq. 179-217.

⁶ A. Hetzer: *Zum Problem der aromunischen Entlehnungen aus dem Albanischen*. Në: BA. NF, Bd. 7 (1982), fq. 109-142; I njëjti: *Zu den albanisch-rumänischen Parallelen*. Në: BA. N.F. Bd. 21, fq. 71 – 80.

⁷ A. Hetzer: *Zur albanischen Literatur im Zeitalter des Sozialismus*. Në: ZfB, 35 (1999) 2, fq. 153-163.

⁸ A. Hetzer: *Shqipnia und Shqenia in Fishtas „Laute des Hochlandes“*. Në: ZfB, 36 (2000) 2, fq. 134-142.

Në fund ai trajtoi edhe tema aktuale si “Shqipja në internet”;¹ Kjo laramani temash dëshmon atë, që pohon ai, se:

“unë nuk jam si gjuhëtarët e tjerë që merren vetëm me strukturat e trurit; mua më intereson gjithmonë njeriu me kushtet e jetesës, dhe gjuha s'është veç pasqyrimi i jetës konkrete”.²

Po ndalemi tani më gjerësisht te 3 kryeveprat e tij për shqipen:

Bëhet fjalë për veprën: “*Libër mësimi i gjuhës së njësuar shqipe*”, botuar së pari nga vetë A. Hetzer më 1978; më vonë me disa ribotime së bashku me Zuzana Finger,³ botimi 4-të, më 1991, ribotimi i 6-të më 2006, i përpunuar plotësisht, me 252; botuar më 2007 si libër xhepi me CD; ribotim 2008.⁴

Libri fillon me një hyrje mbi shkrimin dhe shqiptimin e shqipes, pasojnë 25 mësimet me tema të përgjithshme më të nevojshme, lënda ofrohet në 5 hapa mësimi me: Shprehje praktike, fjalë të reja, pjesë leximi, gramatikë dhe ushtrime. Mësimet plotësohen përmes një liste të literaturës shkencore, tabelave gramatikore, përkthimit të pjesëve të leximit dhe çelësit të ushtrimeve. Në botimet e fundit bashkangjitur është edhe CD-ja, nga e cila mund të dëgjohen ushtrimet për shqiptimin, shprehje të ndryshme praktike dhe pjesë leximi.

Libri është për fillestarë me mësues edhe për studim vetëm. Qëllimi i mësimet është të arrihet kompetenca me gojë dhe me shkrim për përdorim të përditshëm, udhëtime dhe profesion, po ashtu ofron edhe njohuri për civilizimin, pra mbi vendet dhe folësit e shqipes.

Si vepër e dytë për nga rëndësia dhe përdorimi, mendoj që është “*Fjalori shqip-gjermanisht dhe gjermanisht-shqip*”. Një fjalor xhepi me mbi 12 mijë fjalë dhe shprehje. Botimi i parë 1990 dhe i 4-të i aktualizuar dhe plotësisht i përpunuar më 2009.⁵ I njohur dhe më shumë i përdorur nga ata që mësojnë gjermanisht, edhe pse ai së pari e ka konceptuar që do të përdorej kryesisht nga ata që do të mësojnë shqipen. Kjo shihet edhe nga fakti që emrat në gjermanisht nuk e kishin të shënuar gjininë. Por këtë “lëshim” autori e korrigjoi në botimin e vitit 2009, duke pasur parasysh kërkesat dhe këshillat e shumë përdoruesve shqiptarë. Fjalori përfshinë leksikun bazë, terminologjinë e specializuar të tregtisë, gjuhësisë, si dhe nocione bazë të filozofisë, politikës, drejtësisë dhe religjionit. Fjalori është i përdorshëm për mësim të gjuhës, me dhe pa mësues, përkthim si dhe tepër i përshtatshëm, si libër xhepi për udhëtim.

Vepra e tretë në fjalë, punimi i habilitimit: “*Nominalisierung und verbale Einbettung in Varietäten des Albanischen*”⁶ (Substantivimi dhe ndërkallja verbale në gjuhën e shkruar të sotme shqipe), është studimi më i thellë dhe voluminoz i tij mbi shqipen. Libri fillon me një kapitull mbi arealin e gjuhëve të Evropës Juglindore: ballkanologjinë si shkencë interdisiplinare, sfondi gjuhësor dhe socio-historik. Pason kapitulli ku, ndër të tjera trajtohen tipare fonologjike dhe morfosintaksore, të folmet e shqipes, nëndarja e dialekteve të shqipes, dallimet më mes gegërishtes dhe toskërishtes. Veçojmë më tutje krahasimin e lidhës në të folmet e toskërishtes dhe paskajorja në gegërisht. Me nga një kapitull krahason varietet e

¹ A. Hetzer: *Albanisch im Internet*. Në: Hinrichs, Uwe (Hrsg.): Die Südosteuropa-Wissenschaften im neuen Jahrhundert: Akten der Tagung vom 16. - 19.10.1999 an der Universität Leipzig. Wiesbaden: Harrassowitz 2000, fq. 61-68.

² Intervista me A. Hetzer (2006), fq. 234.

³ Zuzana Finger ka qenë lektore e DAAD-së në Universitetin e Prishtinës. Ajo ka botuar po ashtu disa shkrime mbi shqipen dhe shqiptarët.

⁴ HETZER, Armin: *Lehrbuch der vereinheitlichten albanischen Sprache*. Hamburg 1978. 382 S; I njëjti: FINGER, Zuzana: *Lehrbuch der vereinheitlichten albanischen Schriftsprache*. Hamburg: Buske 1991, 4., verb. Auf. 330 S; 2006. XIX, 252 S., 6., völlig neu bearbeitete Auflage, Hamburg: Buske Verlag. Shih online pjesë të botimit të 6-të, të përpunuar plotësisht: <https://buske.de/reading/web/?isbn=9783875484441> (22.11.2017)

⁵ Hetzer, Armin: *Albanisch-deutsches und deutsch-albanisches Taschenwörterbuch: mit rd. 12000 Stichwörtern und Redewendungen*. Hamburg: Buske Verlag 1990; 2., unveränd. Aufl. 1991, 692 S; 4., vollständig überarbeitete Aufl. 2009, XIX, 568 S (im handlichen Format von 10 x 14 cm).

⁶ Hetzer, Armin: *Nominalisierung und verbale Einbettung in Varietäten des Albanischen: eine Untersuchung zur Geschichte der albanischen Schriftsprache am Beispiel erweiterter Verbalprädikate auf areallinguistischem Hintergrund*. Wiesbaden: Harrassowitz 1995. XI, 297 S. (= Balkanologische Veröffentlichungen 28).

gjuhës popullore, dhe gjuhës së shkruar, duke analizuar tekste narrative e deskriptive. Përfundon studimin monografik me kapitullin “Ndërkallja verbale në vështrim gjuhësor tipologjik”.

Nga e gjithë kjo vërejmë kontributin e larmishëm të profesor A. Hetzer si: bibliograf, leksikograf, në fushë të historisë së albanologjisë, si dhe studime mbi letërsinë shqipe etj.

Për të pasqyruar më qartë profilin e këtij studiuesi po përmendim që Hetzer është autor edhe i disa veprave tjera mbi: kinezishten, koreanishten, safardishten dhe estonishten.

Duke u munduar të përfshim të gjitha punimet, falënderojmë autorin për CV-in (aktualizuar së fundi prej tij më 04.07.2003) dhe bibliografinë e dërguar përmes e-mailit, ku gjenden vetëm librat e botuar, por jo edhe punimet e shumta, të cilat i kemi pasur dhe gjetur nëpër revista të ndryshme. Bashkangjitur profesor Hetzer na dërgoi edhe një “Raport për semestrin veror 2006” në UEJL Tetovë, dërguar Fondacionit Johann Herder për punën e tij në atë universitet, ku jepte mësim të gjuhës gjermane në Departamentin e Gjermanistikës.

Në fund pason bibliografia e hartuar, ku jemi përpjekur që të dalë sa më e plotë për të pasqyruar sa më mirë kontributin albanologjik të këtij studiuesi gjerman.

Bibliografi e studimeve albanologjike të Armin HETZER

HETZER, Armin: *Lehrbuch der vereinheitlichten albanischen Sprache*. Hamburg 1978. 382 S;

I njëjti: *Orthographie versus Orthoepie. Zur Situation der albanischen Schriftsprache nach dem Rechtschreibungskongreß vom 25.11.1972 in Tirana*. In: ZfB 14 (1978), fq. 42-49;

I njëjti: *Aspekte der Subjektivität in der albanischen Kulturpolitik (1965-1975)*. Bremen: Übersee-Museum, 1979. 163 S. (Veröffentlichungen aus dem Übersee-Museum, Reihe D, Bd. 5);

I njëjti: *Die strafrechtliche Terminologie in der albanischen Sprache. Eine philologische Wortschatzuntersuchung [...]*. Në: ZfB, 16 (1980), fq. 25-60;

I njëjti: *Wie ist Arnold von Harffs Wörterverzeichnis (1496) zu lesen? Ein Beispiel für das Ineinandergreifen von albanischer und deutscher Sprachgeschichtsforschung*. Në: BA. NF, 6 (1981), fq. 229-262;

I njëjti: *Geschichte und Gegenwart. Probleme der Geschichtsschreibung Albaniens*. Në: BA. NF, 6 (1981), fq. 22-26;

I njëjti: *Der sogenannte Kodex von Berat*. I. Në: BA. NF, 6 (1981), fq. 123-198; I njëjti: (Bearb.): *Das dreisprachige Wörterverzeichnis von Theodoros Anastasiu Kavalliotis aus Moschopolis, gedruckt in Venedig*. Hamburg: Buske 1981. 278 S. (BA. NF, Beiheft 1);

I njëjti: *Griechisches in Südalbanien im Zeitalter der Aufklärung. Untersuchungen zu der einem Prister namens Konstantin zugeschriebenen Berater Handschrift vom Ende des 18 Jahrhunderts*. Në: MZB, 4 (1981-82), fq. 169-218;

I njëjti: *Der sogenannte Kodex von Berat. II. Untersuchungen zu einer anonymen griechisch-albanischen Handschrift vom Ende des 18. Jahrhunderts*. Në: SOF, 41 (1982), fq. 131-179; I njëjti: *Museaks aus Albanien. Beobachtungen am neueröffneten Historischen Museum in Tirana*. Në: ÖOH, 24 (1982), fq. 358-361;

I njëjti: *Albaniens kulturpolitische Entwicklung seit 1945*. Në: BA. NF, 7 (1982), fq. 79-94;

I njëjti: *Zum Problem der aromunischen Entlehnungen aus dem Albanischen*. Në: BA. NF, 7 (1982), fq. 109-142;

I njëjti: *Neues zu Kavalliotis „Protopeiria“ (1770). Beobachtungen am Bukarester Original und einigen Nachdrucken des dreisprachigen Wörterverzeichnisses aus Moschopolis*. Në: BA. NF, 8 (1983), fq. 95-158;

- I njëjti: *Problemtopik zu einer Geschichte des Buchhandels in Albanien bis 1912*. Në: BA. NF, 8 (1983), fq. 159-186;
- I njëjti: *Das Albanerbild in den Erzählungen von Milovan Djilas*. Në: ZfB, 19 (1983), fq. 131-150;
- I njëjti: *Albaniens innere Entwicklung seit 1945*. Në: Südosteuropa-Mitteilungen (München) 23 (1983) 1, fq. 39-49;
- I njëjti: *Der Wortschatz und die Orthographie der „Erveheja“ von Muhamet Kyçyku-Çami*. Në: BA. NF, 8 (1983), fq. 197-290;
- I njëjti:/VIOREL, S. Roman: *Albanien. Ein bibliographischer Forschungsbericht*. München, New York u.a.: Saur 1983. 653 S;
- I njëjti: *Die „Erveheja“ von Muhamet Kyçyku-Çami. Eine Untersuchung zur albanischen Literatur in arabischer Schrift und deren Bedeutung im Rahmen der Nationalbewegung des 19. Jahrhunderts*. Në: SOF, 43 (1984), fq. 181-239;
- I njëjti: *Geschichte des Buchhandels in Albanien. Prolegomena zu einer Literatursoziologie*. Berlin: Osteuropa-Institut an der FU Berlin. In Kommission bei Otto Harrassowitz, Wiesbaden 1984. 212 S. (= Balkanologische Untersuchungen 10);
- I njëjti: *Die innenpolitische Entwicklung Albaniens seit dem Zweiten Weltkrieg*. Në: BA. NF, 9 (1984), fq. 49-72;
- I njëjti: *Der sogenannte Kodex von Berat III*. In: BA. NF, 9 (1984), fq. 153-178;
- I njëjti: *Buchwesen in Albanien. Ein historischer Überblick*. Në: BA. NF, 9 (1984), fq. 179-189;
- I njëjti: *Zur Geschichte der deutschsprachigen Albanologie: 150 Jahre seit Erscheinen von Josef Ritter von Xylanders Handbuch des Albanischen (1835)*, BA. NF, 10 (1985), fq. 179-217;
- I njëjti: *Untersuchungen zur albanischen Aljamido-Literatur am Beispiel einer Handschrift von Muhamet Kyçyku-Çami's „Erveheja“*. Në: ZfB, 21 (1985), fq. 12-40;
- I njëjti: *Zur Textüberlieferung des albanischen Gedichts „Maria vor dem Kreuz“ aus der einem gewissen Konstantin zugeschriebenen anonymen Berater Handschrift*. Në: ZfB, 22 (1986), fq. 11-36;
- I njëjti: *Vom Stellenwert der Empirie. Gegenwärtiger Stand und einige Defizite der linguistischen Forschung in der Albanologie*. Në: BA. NF, 12 (1987), fq. 15-28;
- I njëjti: *Armenier und Albaner. Philologisch-historische Materialien zur Stellung zweier Minderheiten in Osmanischen Reich*. Në: BA. NF, 12 (1987), fq. 29-148;
- I njëjti: *Albanisch-deutsches und deutsch-albanisches Taschenwörterbuch: mit rd. 12000 Stichwörtern und Redewendungen*. 1990. 2., unveränd. Aufl. Hamburg 1991; 4 Aufl. 2009, XIX, 692 S.
- I njëjti:/FINGER, Zuzana: *Lehrbuch der vereinheitlichten albanischen Schriftsprache*. Hamburg: Buske 1991, 4., verb. Auf. 330 S.
- I njëjti: *Ist der Prozeß der Sprachnormierung in Albanien reversibel?* Në: Hinrichs, Uwe [Hrsg.]: *Sprache in der Slavia und auf dem Balkan: slavistische und balkanologische Aufsätze; Norbert Reiter zum 65. Geburtstag*. Wiesbaden: Harrassowitz 1993, fq. 91-100. (Opera Slavica; N.F., 25);
- I njëjti: *Nominalisierung und verbale Einbettung in Varietäten des Albanischen: eine Untersuchung zur Geschichte der albanischen Schriftsprache am Beispiel erweiterter Verbalprädikate auf areallinguistischem Hintergrund*. Wiesbaden: Harrassowitz 1995. XI, 297 S. (= Balkanologische Veröffentlichungen 28);
- I njëjti: *Das lexikalisch-phrasologische Subsystem der religiösen Terminologie im heutigen Albanisch nach den politischen Veränderungen*. Në: ZfB, 32 (1996) 2, fq. 157-166;

I njëjti: *Die vereinheitlichte albanische Sprache nach der politischen Wende*. Në: Schaller, Helmut [Hrsg.]: *Sprache und Politik: die Balkansprachen in Vergangenheit und Gegenwart*. München: Südosteuropa-Gesellschaft 1996, fq. 323-345;
I njëjti: *Zu den albanisch-rumänischen Parallelen*. BA. N.F. Bd. 21, fq. 71 - 80.
I njëjti: *Kulturhistorische Determinanten albanischer Identität*. In: *Dardania* 8, 7 Jhg. (1999), fq. 97-115;
I njëjti: *Zur albanischen Literatur im Zeitalter des Sozialismus*. Në: *ZfB*, 35 (1999) 2, fq. 153-163;
I njëjti: *Albanisch im Internet*. Në: Hinrichs, Uwe (Hrsg.): *Die Südosteuropa-Wissenschaften im neuen Jahrhundert: Akten der Tagung vom 16. - 19.10.1999 an der Universität Leipzig*. Wiesbaden: Harrassowitz 2000, fq. 61-68;
I njëjti: *Shqipnia und Shqenia in Fishtas „Laute des Hochlandes“*. Në: *ZfB*, 36 (2000) 2, fq. 134-142;
I njëjti: *Adnominale Possession im Albanischen*. BA. N.F. Bd. 26/27, 2001/02, 181 – 198.

Botime më të dalluara në fusha të ndryshme dhe për gjuhë të tjera:

Armin Hetzer: *Die koreanische Kanzleisprache: zum linguistischen Profil einer Sondersprache*, Universität Bremen, Bibliothek, Auswertungsstelle für Ostsprachen, 1978.
Armin Hetzer: *Spontaneität und Gewalt*. Übersee-Museum Bremen, 1980 - 513 S.
Armin Hetzer: *Sinica Varia: vier Literaturreferate zur chinesischen Sprache und Geschichte*. Universität Bremen, Bibliothek, 1981. 128 S.
Armin Hetzer: *Sephardisch: Judeo-español, Djudeszmo*. Einführung in die Umgangssprache der südosteuropäischen Juden. Taschenbuch Harrassowitz Verlag, Wiesbaden 2001
Armin Hetzer: *Areallinguistische Probleme des Dakorumänischen*. BA. N.F. Bd. 26/27, 2001/02, 145 – 162.
Armin Hetzer: *Saphardisch – eine vergessene Balkansprache?* BA. N.F. Bd. 26/27, 2001/02, 199 – 230.
Armin Hetzer: *Estnische Literatur: eine historische Übersicht*. O. Harrassowitz Verlag, 2006. 184 S.
Armin Hetzer: *Estnisch - Buch mit Audio-CD: Eine Einführung (Estnisch)* Taschenbuch – 2. Januar 2007.

Shkurtesat

BA. = Balkan-Archiv

Bd. = Band

MZB = Münchener Zeitschrift für Balkankunde

N.F. = Neue Folge

ÖOH = Österreichische Osthefte

SOF = Südost-Forschungen

ZfB = Zeitschrift für Balkanologie